

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE VLORE
ZYRA E NOTERISE FIER
NOTER GAZMIR BEGAJ
E-mail:gazmir.begaj@yahoo.com
cel:(+355)0692136501
Nr. 3099 rep., Nr. 1380 kol.

U PAGUA TAKSA
E PULLES
NOTER G. BEGAJ

KONTRATE DHURIMI KUOTASH SH.P.K

(Baza ligjore : Neni 705 e vijues i K.Civil)

Ne Fier , sot me date 27 Korrik 2017 para meje Noter - Gazmir Begaj me zyre noterie prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier u paraqiten personalisht shtetasit shqiptare me cilesine si me poshte ;

Pala Dhuruese : Theodor Laci , lindur me 27.08.1973 ne Mitrovice , madhor me zotesi te plote per te vepruar identifikuar prej meje Noterit me pasaporten me nr.801707773.

Pala Perfituese : Irfan Isufaj , lindur me 25.01.1958 ne Kurjan,Fier e banues ne Fier , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , i identifikuar me leternjoftimin nr.personal:F80125181E .

Pala dhuruese, Z. Theodor Laci eshte nje prej ortakeve te shoqerise "RECOVERED EARTH GJANICA" shpk e themeluar date 01.07.2017 me qender ne lagjen "Apollonia", sheshi "Nene Tereza" Fier me administrator z.Michael Mills, dhe ortake: Michael Mills me 67,00 % , Theodor Laci me 27,00 % dhe Irfan Isufaj me 6,00 % te kuotave te kapitalit themeltar te kesaj shoqerise . Me vendimin me Nr.1 , date 27.07.2017 , te shoqerise " RECOVERED EARTH GJANICA" shpk , eshte vendosur qe ortaku i kesaj shoqerise z. Theodor Laci , **t'i dhuroje z.Irfan Isufaj** , 4,00 % te kuotave te tij pjesemarrrese ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Ne zbatim te ketij vendimi z. Theodor Laci i dhuron z.Irfan Isufaj 4,00 % te kuotave te tij pjesemarrrese ne kapitalin themeltar te shoqerise .

z.Irfan Isufaj eshte dakort dhe pranon kete dhurim.Ne kete menyre **z. Irfan Isufaj** behet pronar dhe ortak i shoqerise "RECOVERED EARTH GJANICA"shpk duke zoteruar 10,00 % te kuotave te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie .

z.Theodor Laci eshte pronar dhe ortak i shoqerise ,duke zoteruar 23,00 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise .

Z.Michael Mills eshte pronar dhe ortak i shoqerise duke zoteruar 67,00% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pala dhuruese ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate heq dore mbi cdo te drejte pronesia mbi keto kuota duke deklaruar se mbi to nuk ka nuk ka te drejta pronesia dhe te drejta relative me to asnje pale e trete .

Pala dhuruese e garanton palen perfituese se keto kuota objekt kontrate jane plotesisht te lira nga cdo lloj barre pengu , detyrim ndaj te treteve ose sekuestroje mbi to .

Pala dhuruese i kalon pales perfituese pronesine e plote mbi kuotat objekt kontrate me te gjitha tagrat e pronarit te vetem .

Sa me siper eshte shprehje e vullnetit te lire te paleve ne kontrate dhe pasi lexohet nenshkruhet prej tyre pa verejtje ,

Une noteri pas nenshkrimit te paleve ne kontrate legalizoj per sa me siper , ne kater kopje me te njejten vlere origjinale , Kete Kontrate palet pasi e lexojne e gjejne konform vullnetit te tyre e miratojne duke e nenshkruar ate ne prezencen time . Une Noteri vertetoj aktin duke e nenshkruar ate .

DHURUES



NOTER
GAZMIR BEGAJ

A large, stylized handwritten signature in blue ink, appearing to read "Gazmir Begaj".

PERFITUES

A handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains text around its perimeter, including "REPUBLIKA E SHQIPERISE" and "NOTER GAZMIR BEGAJ".